



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:119019

Datë: 16.10.2020

Numri i dokumentit: 01196480

P.nr.676/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Dibran Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.B nga fshati P..., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Artan Haziri nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1488/2020, të datës 01.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe jo publik me datë 09.10.2020, mori dhe shpalli ndërsa me datë 16.10.2020 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri B.B, nga babai H. dhe nëna Z., e lindur P, i lindur me datë në fshatin P... Komuna e Gjilanit ku edhe jeton, ka të kryer 2 vite e gjysmë të shkollës fillore, i martuar, baba i 7 fëmijëve, i punësuar në kompaninë “Eco Higjena” në Gjilan, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë rreth orës, në fshatin..... , Komuna e Gjilanit, në shtëpinë familjare, i pandehuri B.B, me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor me rrip të pantallonave –mjet i rrezikshëm i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë, ka shkaktuar dhunë në familje duke lënduar lehtë të dëmtuarën e mitur –vajzën e tij B.B, në atë mënyrë që për shkak të mllefrit pse e dëmtuara e kishte gënjyer se po shkonte në shkollë dhe kishte shkuar tek një shoqe e saja, i pandehuri kur e kupton këtë, shkon e merr në Gjilan dhe sapo shkojnë në shtëpi, fillimisht i bërtet me fjalët “a të kam dërguar në shkollë apo ku“ dhe e kap për flokë duke e tërhequr me forcë, e godet me shuplaka fytyrës, më pa e nxjerr rripin nga pantallonat dhe e godet në shpinë, kokë, kofshë, këmbë dhe tërë trupin duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjes dhe gërvishtje e qafës, ndrydhje të krahëve dhe regjionit të kofshës majtas, gjak mbledhje në regjionin e shpinës, të evidentuara në raportin mjekësor me numër 21353 të datës 22.09.2020, të lëshuar nga Spitali Regjional i Gjilanit që sipas ekspertizës mjekoligjore cilësohen si dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-ës, andaj, gjykate në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin B.B e:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 2 (dy) vite nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-ës, të pandehurit të lartcekur, koha e kaluar në paraburgim nga data 22.09.2020 deri me datë 09.10.2019, do ti llogaritet në dënimin e kushtëzuar me burgim.

Bazuar në nenin 115 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i KPP-ës nga i pandehuri B.B KONFISKOHET 1 (një) rrip ngjyrë kafe si mjet i kryerjes së veprës penale i cili ka qenë i sekuestruar përkohësisht.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), në emër të shpenzimeve të përpilimit të ekspertizës mjekoligjore shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 01.10.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1488 /2020, kundër të pandehurit B.B nga fshati....., Komuna e Gjiilanit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-ës

Me datë, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, i pandehuri B. B me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare avokati Arton Haziri, e dëmtuara B.B si dhe mbrojtësi i viktimave pranë ZMNV në Gjiilan Egzon Maloku. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij si dhe njoftimit me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e pranon fajësinë për kryerjen e veprave penale të cilat i vihet në barrë, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1-1.4 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza përkatësisht ky pranim i fajësisë gjen mbështetje në provat materiale të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës si: deklaratat e të pandehurit B.B të dhëna në polici dhe prokurori në të cilat i njejtë e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, deklaratat e të dëmtuarës B.B, deklaratat e përfaqësueses e të dëmtuarës B.B ,R. B, fotografitë mbi natyrën e dëmtimit trupor tek e dëmtuara, raporti mjekësor me numër 21353 i datës....., i lëshuar nga Spitali Regional i Gjilanit, ekspertiza mjekoligjore në emrin e të dëmtuarës, vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendit, rripi i sekuestruar, deklaratat e të dëmtuarës, pyetësi për vlerësimin e rrezikut, raporti i oficerëve nga vendi i ngjarjes, raporti i oficerit, raporti fillestar i incidentit, kërkesa dhe parashtrësia e ZMNV në Gjilan, kërkesa dhe raporti i QPS-ës në Gjilan me numër të referencës 04-888, e datës si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë ka gjetur se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri B.B, ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-ës në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në shumë prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale përkatësisht i njëjti ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i njëjti është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre aq sa në gjykatore i njëjti gjatë tërë kohës ka qarë dhe i ka kërkuar falje të

dëmtuarës pendim ky të cilin gjykata e mori si real, i njehti ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij ka kërkuar falje për veprimet e tij, faktin se i njehti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, po ashtu gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njehti bie ndesh ligjin përkatësisht i njehti më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar për asnjë lloj të veprave penale, është mbajtës i familjes, i punësuar dhe nga këto të ardhura siguron mbijetesën e gjithë anëtarëve të familjes përfshirë këtu edhe të dëmtuarën ndërsa si rrethana rënduese gjykata për të pandehurin mori shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale ngase nga provat e bashkangjitura në lëndë vërtetohet se si pasojë e këtyre veprimeve e dëmtuara ka pësuar lëndime trupore të përshkruara si në ekspertizën mjekoligjore gjithashtu si rrethanë rënduese gjykata mori edhe dashjen e të pandehurit për kryerjen e veprës penale ngase nga provat e bashkangjitura në aktin akuzues del se i njehti këtë vepër e ka kryer me dashje dhe atë dashje direkte sepse i njehti pasi kupton se vajza e tij këtu e dëmtuara nuk kishte shkuar në shkollë, nga shtëpia e tij në fshatin P. shkon në Gjilan, e takon të dëmtuarën, e merr dhe e kthen në shtëpi dhe më pas e sulmon fizikisht ashtu siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si rrethanë rënduese gjykata mori edhe moshën e të dëmtuarës meqenëse e dëmtuara është e mitur përkatësisht e moshës 17 vjeçare, po ashtu si rrethanë rënduese gjykata mori edhe faktin se vepra penale është kryer brenda ambientit familjar. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe *qëllimin e dënimit me kusht* i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 5 vite burgim vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale si dhe *sjelljen e mëparshme të kryesit* ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njehti bie ndesh me ligjin andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Duke pasur parasysh se i pandehuri B.B ka qëndruar nën masën e paraburgimit nga data deri me datë....., gjykata në kuptim të nenit 79 të KPRK-ës, kohën e kaluar në paraburgim, të njëjtit ia llogariti në dënimin e kushtëzuar me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6.Vendimi mbi konfiskimin

Gjykata bazuar në nenin 115 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i KPP-ës nga i pandehuri B.B ka konfiskuar 1 (një) rrip ngjyrë kafe si mjet i kryerjes së veprës penale i cili ka qenë i sekuestruar përkohësisht.

7.Vendimi lidhur me publicitetin e seancës.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të prokurorit të shtetit në aktin akuzues për publicitetin e shqyrtimit fillestar si dhe pas dëgjimit të palëve në kuptim të nenit 294 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të KPP-s me qëllim të ruajtjes së jetës personale të të pandehurit dhe të dëmtuarës duke pasur parasysh afërsinë e tyre familjare (babë-bijë) mori aktvendim që seanca e shqyrtimit fillestar të jetë jo publike.

8. Vendimi lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike

Duke pasur parasysh deklarin e përfaqësueses së të dëmtuarës B.B.R B. se e njëjta nuk parashtron kërkesë pasurore juridike gjykata rrjedhimisht nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

9.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), në emër të shpenzimeve të përpilimit të ekspertizës mjekoligjore shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) në emër të ligjit për kompensimin e viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.676/2020, me datë 16.10.2020

Bashkëpunëtori Profesional,
Dibran Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate themelore.